


DËSHTIMET E KUVENDIT NË FUNKSIONALIZIMIN E AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI



Nëntor 2020

Titulli: Dështimet e Kuvendit në Funksionalizimin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi
Autore: Mexhide Demolli Nimani dhe Albana Hasani
Viti i botimit: Nëntor 2020
Dizajni: Ardit Berisha

Publikuar nga:
Lëvizja FOL
Andrea Gropa nr.35
Prishtina 10000, Republika e Kosovës
info@levizjafol.org
+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2020. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.



Ky botim është realizuar me përkrahjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbytja e këtij raporti pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e Lëvizjes FOL që është përgjegjëse për faktimin dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jo domosdoshmërisht i paraqesin ato të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.

PËRMBAJTJA

1	Hyrje
3	1. Baza ligjore e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi
6	2. Procesi i përzgjedhjes së Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi
6	2.1 Shpallja e parë e konkursit dhe procesi
7	2.2 Shpallja e dytë e konkursit dhe procesi
9	2.3 Shpallja e tretë e konkursit dhe procesi
13	3. Legjitimiteti i vendimeve të agjencisë pa emërimin e komisionerit
14	4. Nr. i ankesave të dërguara tek agjencia për informim dhe privatësi dhe tek avokati i popullit
18	Rekomandime

HYRJE

E drejta për qasje në dokumente publike është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht në nenin 41 të saj, si e drejtë themelore të cilën e gëzojnë të gjithë qytetarët. Ligji për Qasjen në Dokumente Publike i vitit 2010 , i jep të drejtë secilit person që përmes dërgimit të një kërkesë në çfarëdo forme, të marrë informata për një dokument zyrtar, pa u obliguar të shpjegoj arsyen e kërkesës. Ky ligj gjithashtu i obligon institucionet publike që të përgjigjen brenda shtatë ditësh në lidhje me kërkesën e pranuar. Në anën tjetër i jep të drejtën kërkuarit të informacionit t'i drejtohet me ankesë Agjencisë për Informim dhe Privatësi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh, në rast se institucioni publik ka heshtur, nuk është përgjigjur, apo ka refuzuar kërkesën për qasje në dokumente publike.

Në qershor të vitit 2019 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin e ri për Qasje në Dokumente Publike. Një ndër ndryshimet substanciale dhe më të rëndësishme të parapara në këtë ligj është institucioni i Komisionerit, i cili është organ i pavarur dhe institucion themelor në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, si dhe të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Rrjedhimisht edhe vetë fillimi i zbatimit të dispozitave të këtyre ligjeve është i ndërlidhur me emërimin e komisionerit.

Komisioneri është udhëheqës i Agjencisë për Informim dhe Privatësi, dhe si i tillë e përfaqëson, organizon dhe koordinon punën e kësaj Agjencie. Komisioneri për Informim dhe Privatësi është autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike dhe për këtë shkak, pamundësia e përzgjedhjes së tij e ka stagnuar punën e Agjencisë në tërësi.

Përzgjedhja e udhëheqësit të kësaj agjencie ka dështuar të bëhet për tri herë me radhë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Herën e parë asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur të kualifikohet, herën e dytë përzgjedhja e tij ka dështuar për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, ndërsa në herën e tretë asnjëri nga kandidatët nuk arriti ti marrë votat e nevojshme.

Për shkak të mos zgjedhjes së komisionerit, Agjencia për informim dhe Privatësi ende nuk ka nxjerrë akte nënligjore për organizimin e brendshëm të Agjencisë, akte këto të domosdoshme për funksionimin e punës së kësaj Agjencie dhe që duhej të nxirreshin 6 muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, edhe 1 vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka dështuar të publikoj rekomandimet, udhëzimet, opinionet, sqarimet dhe qëndrimet për çështjet në fushën e mbrojtjes së të dhënave, vendimet e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me qasjen në dokumente publike, si dhe njoftime të tjera të rëndësishme, siç parashihet në nenin 67 të këtij ligji.

Përveç dështimit në përmbushjen e obligimeve ligjore, dështime të cilat e kanë lënë këtë institucion jofunksional, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka arritur të ju përmbahet zotimeve të dhëna në nënshkrimin e Memorandum Bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (përfaqësuar nga ana e Ambasadës Britanike), të nënshkruar me 2 korrik 2020. Sipas nenit 3 të këtij memorandum, Kuvendi i Kosovës është zotuar që ky projekt të zbatohet në kohë, në mënyrë transparente dhe të paanshme, si dhe të zbatojë rekomandimet nga partneri zbatues dhe si pasojë e mos përmbushjes së këtyre obligimeve, këta partner janë shprehur të zhgënjyer për dështimin e këtij procesi dhe kanë njoftuar se janë tërhequr nga procesi i rekrutimit për këtë pozitë.

Agjencia për Informim dhe Privatësi është jofunksionale që nga viti 2016, respektivisht që nga koha kur ishte larguar këshilli i këtij institucioni. Ndërkaq me miratimin e ligjit të ri u parapa ristrukturimi i AIP-së dhe krijimi i pozitës së komisionerit. Rrjedhimisht, edhe 1 vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Informim dhe Privatësi nuk është konsoliduar sipas detyrimeve të ligjit dhe kësisoj, duke mos i përmbushur predispozitat ligjore, ajo vazhdon të përballet me sfida për funksionimin efektiv.

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 41.

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, 2019.

³ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzimi Administrativ nr. 05/2013 për Transparençën në Komuna, Neni 4.

⁴ Ministria e Administratës Publike, Udhëzimi Administrativ nr. 03/2011 për ueb faqet e Institucioneve Publike, Neni 4.

⁵ Po aty, neni 5.

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji (nr. 02/L-37) për Përdorimin e Gjuhëve, 2006.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes i Kuvendit të Kosovës ka qenë në proces të përzgjedhjes së kandidatëve për komisioner. Ndërkaq i tërë procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të kandidatëve është monitoruar për së afërmi nga Koalicioni Ad-Hoc, i përbërë nga Lëvizja FOL, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Instituti GAP, Instituti D4D, Grupi për Studime Politike dhe Juridike, Çohu, Instituti Demokratik i Kosovës dhe Flutura Kusari, duke i analizuar CV-të e kandidatëve dhe duke monitoruar drejtpërdrejt edhe zhvillimin e mbajtjes së intervistave.

1. BAZA LIGJORE E KOMISIONERIT TË AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI

Para hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Qasje në Dokumente Publike (NR. 06/L-08) në vitin 2019, çështja e qasjes në informacionet me karakter publik në Kosovë është rregulluar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (NR.03/L-215) të vitit 2010, i cili kishte krijuar një standard efektiv dhe mbështetje ligjore sa i përket qasjes në informacionet me karakter publik. Ndërkaq në ligjin e ri, ndër çështjet tjera që janë rregulluar e që kanë të bëjnë me avancim të transparencës në institucionet publike, si risi është paraparë edhe institucioni i Komisionerit. Pra ky institucion, i cili nuk ishte paraparë në ligjin paraprak dhe që pritet të zgjedhet për herë të parë në Kosovë, është autoriteti përgjegjës për sigurimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Rrjedhimisht, në kuptim të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (NR. 06/L-082, GZRK 6/2019), dhe Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike (NR. 06/L-08, GZRK 13/2019), Komisioneri është organ i pavarur, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës, i cili vepron në kuadër të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, dhe është përgjegjës për sigurimin e qasjes në dokumente publike dhe në mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit.

Në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndër të tjera, janë përcaktuar kriteret dhe e tërë procedura e përzgjedhjes, si dhe zgjatja dhe përfundimi i mandatit të komisionerit. Sipas nenit 60 të këtij ligji, komisioneri zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, për një mandat pesë (5) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat shtesë.

Në nenin 59 të këtij ligji janë përcaktuar kriteret për përzgjedhjen e komisionerit. Rrjedhimisht, kandidatët për komisioner duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, të kenë diplomë universitare në njërin nga këto fusha: juridik, administratë publike apo marrëdhënie ndërkombëtare, të kenë së paku 8 vite përvojë pune profesionale (nga të cilat së paku 5 vite përvojë në pozita udhëheqëse), të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale apo të mos ketë pasur aktakuzë gjatë pesë viteve të fundit, të kenë integritet të lartë moral dhe profesional, të kenë përvojë dhe njohuri të dalluara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të mos jenë larguar nga puna ose shërbimi civil me masë disiplinore, si dhe të mos kenë ushtruar asnjë funksion në parti politike gjatë pesë 5 viteve të fundit. Gjithashtu nuk duhen të jenë deputetë të Kuvendit në Legjislaturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që i zgjedhin ata, apo të kenë qenë anëtarë të Kabinetit Qeveritar në mandatin e fundit.

Në nenin 60, përveç të tjerave, përcakton se lista e ngushtë e kandidatëve për komisioner, e përzgjedhur nga paneli përzgjedhës, përmban tre kandidatë. Paneli përzgjedhës, listën e kandidatëve ia dorëzon komisionit, i cili listën e ngushtë ia propozon Kuvendit të Kosovës. Propozimi i komisionit gjithashtu përmban arsyetimin përse paneli u ka dhënë përparësi disa kandidatëve, në krahasim me kandidatët tjerë.

Ndërkaq në nenin 64 të këtij ligji janë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, që udhëhiqet dhe përfaqësohet nga komisioneri, dhe ndër të tjera përmendet dhënia e këshillave organeve publike dhe private për çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave, informimi i publikut për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave, promovimi dhe përkrahja e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale, vendosjen lidhur me ankesat e subjektit të të dhënave, këshillimin e Parlamentit, Qeverisë, si dhe institucionet dhe organet e tjera të brendshme mbi masat legjislative dhe administrative në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë, për sa i takon përpunimit të të dhënave.

⁴ Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 2019, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Përveç kësaj, sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, përkatësisht sipas nenit 28 të tij, Agjencia për Informim dhe Privatësi ka edhe këto përgjegjësi: të monitorojë dhe raportojë në lidhje me përputhshmërinë dhe respektimin e këtij ligji nga institucionet publike, të rekomandojë ndryshime dhe reforma të natyrës së përgjithshme, por edhe specifike të drejtuara një institucioni specifik në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike, të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse për organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve për zyrtarët publikë për qasje në dokumente publike dhe për zbatimin efektiv të këtij ligji, të publikojë detyrimet e institucioneve publike që rrjedhin nga ky ligj dhe të drejtat e secilit person të parashikuar me këtë ligj, si dhe të ndërmarrë dhe shqiptojë ndonjëherë nga masat e parashikuara me këtë ligj për zbatimin efektiv të këtij ligji.

Gjithashtu, sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, përkatësisht sipas nenit 32 të saj, Agjencia për Informim dhe Privatësi është kompetente për shqiptimin e gjobave ndaj institucioneve publike dhe zyrtarëve përgjegjës, të cilët në ndonjë mënyrë pamundësojnë, pengojnë ose kufizojnë realizimin e të drejtave për qasje në dokumente publike, apo që lejojnë dëmtimin, shkatërrimin, fshehjen ose në ndonjë formë tjetër e bëjnë të paqartë dokumentin publik.

Për më tepër, sipas nenit 62 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Informim dhe Privatësi financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe ka vijën e vet buxhetore e cila i garanton pavarësinë e saj. Agjencia përgatit propozim-buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

2. PROCESI I PËRZGJEDHJES SË KOMISIONERIT TË AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI

Komisioneri i Agjencisë për informim dhe Privatësi ka dështuar të zgjidhet për tri herë me radhë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kjo për shkak se, përkundër përpjekjeve në të tri herat, Kuvendi nuk ka arritur ende ta bëjë përzgjedhjen e tij. Herën e parë asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur të kualifikohet, herën e dytë përzgjedhja e tij ka dështuar për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, ndërsa në herën e tretë asnjëri nga kandidatët nuk arriti ti marrë votat e nevojshme. Në tekstin në vazhdim do të shtjellohet hollësisht i tërë procesi.

Fillimisht duhet të theksohet se ekspertët e angazhuar nga Ambasada Britanike kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm dhe tejet profesional në tërë procesin e vlerësimit të kandidatëve për komisioner. Ky kontribut është shprehur në veçanti në parapërgatitjet e mbajtura për panelin përzgjedhës nga ekspertët britanik para çdo interviste, ndërkaq secili prej kandidatëve njëkohësisht është vlerësuar nga Paneli Përzgjedhës në njërën anë, dhe nga ekspertët britanik në anën tjetër. Fillimisht secilit prej këtyre kandidatëve i është dhënë mundësia që të filloj me prezantimin në lidhje me sfidat e Agjencisë dhe se si do të përballen me to në të ardhmen si Komisioner, duke u pasuar nga pyetjet tjera të bëra nga anëtarët e Panelit Përzgjedhës, e që kanë të bëjnë me mendimin strategjik, lidërsip, komunikim, zgjidhjen e problemeve, orientimin kah rezultatet, menaxhim dhe rrjetëzim.

2.1 SHPALLJA E PARË E KONKURISIT DHE PROCESI

Kuvendi i Kosovës e ka shpallur për herë të parë konkursin për zgjedhjen e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi me datën 08 prill 2019 dhe ka zgatur deri me 23 prill 2019.

Ky konkurs është publikuar në ueb-faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës, si dhe në gazetat e përditshme “Zëri”, “Epoka e Re” dhe “Bota Sot” (në të dy gjuhët zyrtare). Konkursi, po ashtu, është transmetuar dy herë në ditë në “RTK” (në gjuhën serbe) me datat 08 prill, 12 prill, 15 prill, 21 prill dhe 22 prill 2019, si dhe në radion “Kosova e Lirë”, dy herë në ditë (në gjuhën shqipe), me datat 08 prill, 15 prill dhe 21 prill 2019.

⁵ Për më tepër, shih: <https://levizjafol.org/te-anulohet-perzgjedhja-e-komisionerit-per-informim-dhe-privatesi/>

Numri i përgjithshëm i kandidatëve për pozitën e komisionerit ka qenë 11, dhe pas vlerësimit të dokumenteve të paraqitura dhe biografive të tyre, 4 kandidatë janë përzgjedhur në listën e ngushtë për t'u intervistuar nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, i përbërë nga Haxhi Shala (Nisma Social Demokratike), Fadil Beka (PDK), Xhelal Sveçla (LVV) dhe Aida Dermaku (Partia Social Demokratike).

Intervistat janë mbajtur me 04 maj 2019, megjithatë sipas Panelit Përzgjedhës asnjë nga katër kandidatët nuk ka arritur të kualifikohet për t'u përzgjedhur për pozitën e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi nga ana e Kuvendit të Kosovës. Si rezultat i kësaj, konkursi është rishpallur prapë me qëllim të ofrimit të mundësisë së pjesëmarrjes së kandidatëve të tjerë më të kualifikuar, si dhe të ofrimit të mundësisë së dytë për aplikim kandidatëve të kësaj shpalljeje.

Paneli Përzgjedhës përbëhej nga anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (Haxhi Shala, Aida Derguti, Fadil Beka dhe Xhelal Sveçla) dhe ekspertët britanik të angazhuar nga Ambasada Britanike. Ndërkaq monitorues nga shoqëria civile ishin organizatat e koalicionit ad-hoc, të përbërë nga: Lëvizja FOL, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Instituti GAP, Instituti D4D, Grupi për Studime Politike dhe Juridike, Çohu, Instituti Demokratik i Kosovës dhe Flutura Kusari. Gjatë këtij procesi, monitoruesit nga shoqëria civile e kanë kundërshtuar fuqishëm emërimin e këtyre kandidatëve, për shkak se sipas tyre, kandidatëve ju mungonte vizioni, strategjia dhe përgatitja e duhur për këtë pozitë, e në veçanti kanë kundërshtuar kandidaturën e zyrtarëve aktual të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Bujar Sadiku dhe Jeton Arifi, për shkak të dyshimeve se janë të afërt me Partinë Demokratike të Kosovës.

2.2 SHPALLJA E DYTË E KONKURSIT DHE PROCESI

Kuvendi i Kosovës e ka shpallur konkursin e dytë të përzgjedhjes së kandidatëve për komisioner me datën 29 maj 2019 dhe ka zgjatur deri me datën 12 qershor 2019.

Në ditën e shpalljes konkursi është publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës, në të përditshmet “Zëri”, “Epoka e Re” dhe “Bota Sot” (me datën 20 maj në të dy gjuhët zyrtare). Konkursi, po ashtu, është transmetuar dy herë në ditë në radio “RTK” (në gjuhën serbe) me datat 29 maj, 01 qershor, 03 qershor, 07 qershor dhe 11 qershor 2019 dhe në radion “Kosova e Lirë”, dy herë në ditë (në gjuhën shqipe), me datat 29 maj, 05 qershor, 09 qershor dhe 11 qershor 2019.

Numri i përgjithshëm i kandidatëve për pozitën e komisionerit ka qenë 20, ndërkaq pas vlerësimit të dokumenteve të paraqitura dhe biografive të tyre, 10 kandidatë janë përzgjedhur në listën e ngushtë për t'u intervistuar nga ana e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ndërsa në fazën e intervistave kanë marrë pjesë vetëm shtatë kandidatë, nga gjithsej 10 sa kanë qenë të përzgjedhur në listën e ngushtë.

Intervistat për këta shtatë kandidatë janë mbajtur në datat 09 dhe 10 korrik 2019. Sipas Panelit Përzgjedhës, vetëm një nga të gjithë kandidatët ka arritur të shfaqë cilësitë dhe njohuritë e duhura për t'u përzgjedhur si Komisioner i Agjencisë për Informim dhe Privatësi nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Paneli Përzgjedhës në këtë proces përbëhej nga anëtarët e Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Kosovës (Haxhi Shala, Aida Derguti, Fadil Beka dhe Xhelal Sveçla) dhe nga ekspertët e angazhuar nga Ambasada Britanike, ndërsa monitorues nga shoqëria civile ishin: Lëvizja FOL, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Instituti GAP, Instituti D4D, Grupi për Studime Politike dhe Juridike, Çohu, Instituti Demokratik i Kosovës dhe Flutura Kusari.

Kësaj radhe Paneli intervistues arriti ti dërgoj tre emra të kandidatëve në Kuvend për votim, të cilët ishin: Krenare Sogojeva Dërmaku, Agron Behrami dhe Enver Bujari. Ndërkaq, në bazë të vlerësimit nga ana e ekspertëve britanik, sipas tyre Krenare Sogojeva Dërmaku është kandidatja që duhej të votohet nga deputetet e Kuvendit të Kosovës. Për këtë arsye, organizatat e shoqërisë civile përmes letrave të dërguara secilit deputet dhe letrave publike, ju kishin bërë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të marrin parasysh vlerësimet e Komisionit dhe projektit të Ambasadës Britanike dhe votën e tyre ta bazojnë në këtë vlerësim profesional, e jo në preferencat e tyre politike e partiake.

Ndonëse i shpallur për herë të dytë, Kuvendi i Kosovës përsëri nuk ka arritur ta bëjë përzgjedhjen e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe kësaj here si rezultat i krizave politike në vend, respektivisht për shkak të shpërndarjes së Kuvendit dhe i tërë procesi u kthye në pikën zero.

Ndryshe, edhe gjatë këtij procesi përfaqësuesit e shoqërisë civile kishin shfaqur një reagim në formë të letrës publike të drejtuar Komisionit për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, ku kishin kërkuar që kandidatët nga procesi i kaluar (Bujar Sadiku dhe Jeton Arifi) të mos përzgjedhin në krye të këtij institucioni, për arsytet e njëjta me reagimin e bërë ndaj konkursit të parë. Gjithashtu përmes kësaj letre publike, monitoruesit e shoqërisë civile kanë kërkuar shprehimisht që të merren seriozisht shqetësimet e tyre lidhur me këta kandidatë.

2.3 SHPALLJA E TRETË E KONKURSIT DHE PROCESI

Konkursi për zgjedhjen e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi është shpallur për herë të tretë (pas një viti) nga Kuvendi i Kosovës me datën 26 maj 2020 dhe ky konkurs ka zgjatur deri me datën 09 qershor 2020.

Konkursi është publikuar me datën 26 maj 2020 në të përditshmet “Koha Ditore” dhe “Epoka e Re”, në versionin online, pasi që sipas Kuvendit këto kanë qenë të vetmet të përditshme që iu janë përgjigjur kërkesës së tyre për publikim të konkursit. Konkursi është publikuar, po ashtu, në ueb faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës dhe është dërguar për transmetim në “Radio Kosova”- programi në gjuhën serbe, për t’u lexuar dy herë në ditë në datat 26 maj, 02 qershor dhe 08 qershor 2020.

Paneli Përzgjedhës i këtij procesi fillimisht ishte paraparë të mbliidhet me datën 24 qershor 2020 për të bërë hapjen e aplikacioneve, mirëpo për shkak të pandemisë COVID-19, hapja e aplikacioneve është shtyrë deri me datën 22 korrik 2020.

Numri i përgjithshëm i kandidatëve për pozitën e komisionerit që kanë aplikuar gjatë këtij konkursi ka qenë 12, ndërkaq pas vlerësimit të dokumenteve të paraqitura dhe biografive të tyre, 6 kandidatë janë përzgjedhur në listën e ngushtë për t’u intervistuar nga ana e Komisionit për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, të asistuar nga projekti i Ambasadës Britanike. Anëtarë të këtij komisioni ishin deputetët: Fatmire Kollçaku – Kryesuese (VV), Ganimete Musliu – Anëtare (PDK), Bekë Berisha – Anëtar (AAK), Ilir Tasholli – Anëtar (LDK), Rasim Demiri – Anëtar (Koalicioni VAKAT).

Procesi i intervistimit të kandidatëve ka zgjatur dy ditë, ndërsa nga 5 kandidatët e intervistuar, komisioni vlerësues kishte përzgjedhur kandidatët: Bujar Sadiku, Krenare Sadiku – Sogojeva dhe Muharrem Mustafa si kandidatë potencial për tu emëruar si kryesues të Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Pas procesit të plotë të përzgjedhjes, projekti i Ambasadës Britanike ka vlerësuar kandidaten Krenare Sogojeva Dermakun me më së shumti pikë. Ndërkaq organizatat

e Koalicionit ad-hoc (FOL, KCSF, GLPS, Çohu, KDI, Flutura Kusari, GAP dhe D4D) ju kanë bërë thirrje deputeteve të Kuvendit të Kosovës që në përputhje me zotimin e dhënë, të marrin parasysh vlerësimet e projektit të Ambasadës Britanike dhe votën e tyre ta bazojnë në këtë vlerësim profesional, e jo në preferencat e tyre politike e partiake.

Mirëpo asnjëri nga këta kandidatë nuk arriti ti marrë votat e nevojshme, prandaj përzgjedhja e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi dështoj për të tretën herë me radhë.

Për dështimin e këtij procesi, përveç reagimeve të organizatave të shoqërisë civile, reagim ka pasur edhe nga Ambasada Britanike, e cila këtë herë kishte dhënë rekomandime për përzgjedhje të kandidatëve. Rrjedhimisht, Ambasada Britanike ka shprehur zhgënjim për dështimin e këtij procesi dhe ka njoftuar se ekspertët britanik janë tërhequr nga procesi i rekrutimit për këtë pozitë.

Në reagimin e Ambasadës Britanike, ndër të tjera, shkruante: “Kemi ndjekur me zhgënjim dështimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të emërojë Komisionerin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi me 14 gusht. Procesi transparent dhe meritore, i mbështetur nga projekti ynë i rekrutimit, kishte nxjerrë dy kandidatë të përshtatshëm. Mos emërimi i asnjërit prej tyre vë në dyshim zotimin e deklaruar të partive politike për të zbatuar Memorandumin e Mirëkuptimit me Ambasadën Britanike, por ç’është më e rëndësishmja, dërgon sinjal negativ për profesionistët e pavarur në Kosovë dhe shpresat e tyre për të kontribuar në Institucionet e Kosovës. Çdo emërim publik do të duhej të marr parasysh vetëm interesat e vendit dhe të qytetarëve të tij, dhe jo interesin e ngushtë partiak. Dështimi i Kuvendit për të emëruar Komisararin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi do t’i lërë qytetarët kosovarë pa mbrojtje të duhur institucionale të privatësisë dhe të dhënave. Kjo gjithashtu do të çojë në përsëritje të procesit të rekrutimit për herë të katërt dhe do të shkaktojë vonesë në fondet e BE-së për Agjencinë. Procesi i radhës nuk do të mbështetet nga projekti ynë i rekrutimit. Ne nuk do të çojmë poshtë paratë e tatimpaguesve britanikë në proceset e përsëritura që ishin transparente dhe të zhvilluara me rregull, dhe që nxorën kandidatë që i plotësojnë kushtet për emërim”.

⁵ Për më tepër, shih: <http://levizjafol.org/leter-publike-kandidatet-nga-procesi-i-kaluar-te-mos-zgjedhen-komisioner/>.

⁷Për më tepër, shih tepër, shih:

<https://levizjafol.org/ftojme-kuvendin-e-kosoves-te-procedoje-me-perzgjedhjen-e-komisionerit-per-informim-dhe-privatesi-2/>.

Për më tepër, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Bujar Sadiku, me 22 maj 2019 i ishte drejtuar me kërkesë Kuvendit ku kishte kërkuar nga Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes ti japë autorizim atij si drejtor i Agjencisë, që të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe procedurale “për të mos lejuar bllokimin e funksionimit të këtij autoriteti publik, duke nxjerrë rregulloren e brendshme dhe aktet tjera administrative, siç ka përcaktuar ligji, i cili mundëson rikonstruktimin dhe funksionalizimin e Agjencisë” .

Ndërkaq me 17 gusht 2020, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Bujar Sadiku, i është drejtuar për herë të dytë Kuvendit të Republikës së Kosovës, konkretisht Komisionit për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, me kërkesë ”për lëshimin e një autorizimi të posaçëm i cili do ti mundësonte Drejtorit të Përgjithshëm të AIP-së që njëkohësisht të kryente disa veprime”

Konkretisht drejtori i AIP-së kërkon që ta lejojë të kryejë veprime që lidhen me funksionalizimin në mënyrë të plotë të Agjencisë, ta fuqizojë me të drejtën e nënshkrimit të akteve nënligjore dhe t’ia mundësojë të drejtën e vendimmarrjes në fushën e inspektiveve dhe vendimeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës së qasjes në dokumente publike.

Ndërsa organizatat përbërëse të koalicionit Ad- Hoc (Lëvizja FOL, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Instituti GAP, Instituti D4D, Grupi për Studime Politike dhe Juridike, Çohu, Instituti Demokratik i Kosovës dhe aktivistja Flutura Kusari) kanë reaguar duke shprehur shqetësim në lidhje me kërkesën e drejtorit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për autorizim të posaçëm drejtuar Kuvendit.

Në letrën e dërguar Kryetares së Kuvendit të Kosovës, znj. Vjosa Osmani, organizatat e shoqërisë civile përbërëse të Koalicionit Ad- Hoc kanë kërkuar nga Kryesia e Kuvendit “që të mos e përfillë këtë kërkesë të kundërligjshme dhe të mos i ofrojnë autorizime të posaçme individëve në AIP”. Ndër të tjera në këtë reagim thuhet se letra e AIP-së nuk i referohet asnjë baze ligjore ekzistuese dhe autorizimet e kërkuara nga z. Sadiku janë kompetencë ekskluzive e Komisionerit për Informim dhe Privatësi dhe jo e Drejtorit të Përgjithshëm të AIP-së, prandaj një veprim i tillë do të ishte i kundërligjshëm, si dhe se një autorizim i tillë i kundërligjshëm nuk do të ndihmonte AIP-në të përfitonte nga fondet ndërkombëtare por do t’i rrezikonte ato në të ardhmen.

Pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes erdhi në përfundim se nuk është kompetente për trajtimin e kësaj çështje dhe vendosi që kërkesën ta procedoj tek Kryesia e Kuvendit, e cila pastaj e kishte kundërshtuar në tërësi kërkesën e drejtorit të AIP-së, Bujar Sadiku.

Ndërkaq në mbledhjen e mbajtur me 23 shtator 2020, Kryesia e Kuvendit kishte vendosur gjithashtu që të mos rishpall konkursin, por fillimisht të procedohet me plotësim/ndryshimin e ligjit ekzistues.

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për shkak të pengesave të krijuara gjatë zbatimit në praktikë, përveç që nuk është i nevojshëm, kjo paraqet edhe kërcënim të sigurisë juridike dhe vë në pikëpyetje funksionimin e rregullt të institucioneve. Prandaj ne, si organizata të shoqërisë civile, do të kundërshtojmë fuqishëm krijimin e praktikave të tilla.

¹⁰ Letra e organizatave të koalicionit Ad- Hoc drejtuar Kryetares së Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, me temën: “Agjencia për Informim dhe Privatësi kërkon nga Kuvendi autorizime të kundërligjshme”.

¹¹ Për më tepër, shih: <https://levizjafol.org/agjencia-per-informim-dhe-privatesi-kerkon-nga-kuvendi-autorizime-te-kunderligjshme/>.

3. LEGJITIMITETI I VENDIMEVE TË AGJENCISË PA EMËRIMIN E KOMISIONERIT

Sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kompetente për marrjen e vendimeve në Agjencinë për Informim dhe Privatësi është udhëheqësi i këtij institucioni, respektivisht Komisioneri i Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Në nenin 54 të këtij ligji thuhet se ndaj vendimit përfundimtar të komisionerit, pala e pakënaqur mund të hap konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Dështimi i përzgjedhjes së Komisionerit për Informim dhe Privatësi e ka stagnuar në tërësi punën e AIP-së si institucion kyç për sigurimin e qasjes në dokumente zyrtare, duke bërë kështu që vendimet e këtij institucioni të pranuar nga zyrtarët tjerë të këtij institucioni gjatë kësaj periudhe (në mungesë të komisionerit), të konsiderohen të pavlefshme.

Kjo mund të dëshmohet edhe nga dispozitat alternative të ligjeve përkatëse. Në nenin 27 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (në tekstin e mëtejshëm: LPPA), thuhet se nëse vendimi përfundimtar merret nga ndonjë zyrtar tjetër i organit publik, dhe jo nga zyrtari përgjegjës i përcaktuar me ligj, zyrtari tjetër mund të formulojë projekt-aktin apo kontratën administrative dhe të ia paraqet atë për miratim dhe nënshkrim zyrtarit përgjegjës të përcaktuar nga ligji. Duke ju referuar dispozitës së lartpërmendur, zyrtarët tjerë të këtij institucioni nuk mund të marrin vendime pa nënshkrimin e zyrtarit kompetent, pra pa nënshkrimin e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Ndërkaq në nenin 26 të këtij ligji thuhet se titullari i organit publik cakton një njësi përgjegjëse, nëse e njëjta nuk është përcaktuar me ligj të veçantë, me akt nënligjor apo me rregullat e brendshme administrative të organizimit, ndërsa ky vendim duhet të bëhet publik me mjete të përshtatshme, përfshirë ueb-faqen e organit publik. Në këtë rast Kuvendi i Republikës së Kosovës do të duhej që me vendim të përcaktonte njësinë përgjegjëse.

Përkundër faktit se Komisioneri për Informim dhe Privatësi nuk është zgjedhur ende, gjatë periudhës korrik 2019 – korrik 2020 Agjencia për Informim dhe Privatësi ka dhënë 10 këshilla ndaj zyrtarëve përgjegjës të institucioneve dhe ka sjellë gjithsej 28 vendime, prej të cilave 4 vendime janë aprovuese, 5 vendime janë refuzuese dhe 16 prej tyre janë lëndë të mbyllura në dobi të palës pa vendim, vendime këto të nënshkruara nga zyrtarë të tjerë të këtij institucioni. Ndërkaq edhe 3 lëndë kanë qenë në shqyrtim e sipër nga ky institucion.

¹² Të dhëna të marrura nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.


4. NR. I ANKESAVE TË DËRGUARA TEK AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI DHE TEK AVOKATI I POPULLIT

Gjatë periudhës korrik 2019 – maj 2020 në Agjencinë për Informim dhe Privatësi janë parashtruar gjithsej 24 ankesa, prej të cilave 6 janë parashtruar në vitin 2019 dhe 18 në vitin 2020, ndërsa edhe 11 ankesa të kësaj periudhe kanë mbetur në shqyrtim e sipër. Sa i përket kërkesave për këshilla/ interpretim të drejtë të ligjit, gjatë kësaj periudhe në Agjencinë për Informim dhe Privatësi janë parashtruar 12 kërkesa. Ankesat e parashtruara kryesisht janë në lidhje me publikimin e të dhënave personale, marketingun e drejtpërdrejt, qasje të paautorizuar në të dhënat personale, përpunim të karakteristikave biometrike etj.

FOL




TË DHËNAT MBI ANKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE DREJTUAR AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI (AIP)



¹² Të dhëna të marrura nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

ANKESAT DHE KËSHILLAT PËR PRETENDIM TË KEQPËRDORIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE



*ANKESAT JANË TË LLOJIT SI: PUBLIKIMI I TË DHËNAVE PËRSONALE, MARKETINGU I DREJTPËRDREJT, QASJE E PAAUTORIZUAR NË TË DHËNA PËRSONALE, PËRPUNIM TË KARAKTERISTIKAVE BIOMETRIKE, ETJ.


Sipas nenit 21 të Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike secili person ka të drejtë t'i drejtohet Institucionit të Avokatit të Popullit me kërkesë apo ankesë nëse konsideron që ndonjë e drejtë e njohur me këtë ligj apo akte të tjera për qasje në dokumente publike është cenuar.

Gjatë periudhës 19 korrik 2019 deri me 31 maj 2020 në këtë institucion janë parashtruar 62 ankesa, 17 prej të cilave janë parashtruar nga OJQ-të, 17 nga mediat dhe të tjerat nga qytetarët. Prej këtyre ankesave, 59 janë të pranueshme për hetim, ndërsa 3 ankesa të papranueshme (për shkak se nuk ka shkelje, apo për shkak të mos interesimit të ankuesit).

FOL



ANKESAT E PRANUARA NGA AVOKATI I POPULLIT RRETH QASJES NE DOKUMENTE PUBLIKE




(19 KORRIK 2019 - 31 MAJ 2020)

¹³ Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, neni 21, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2019.

¹⁴ Të dhëna të pranuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, përmes kërkesës për qasje në dokumente publike

ANKESAT E PRANUARA PËR HETIM

(19 KORRIK 2019 - 31 MAJ 2020)



REKOMANDIME

- Sa më shpejt të zgjedhet Komisioneri i Agjencisë për Informim dhe Privatësi, në mënyrë që sa më parë të arrihet funksionalizimi i Agjencisë.
- Të mos ndryshohet Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Praktika e ndryshimit të ligjeve sa herë që shfaqen vështirësi në zbatimin e tij në praktikë paraqet anomali juridike dhe si e tillë nuk duhet të përvetësohet. Kjo përveç që nuk është e nevojshme, paraqet edhe kërcënim të sigurisë juridike dhe vë në pikëpyetje funksionimin e rregullt të institucioneve.
- Të merren parasysh edhe në vazhdimësi përvojat e mira dhe praktikrat e krijuara gjatë bashkëpunimit me ekspertët britanik.
- Të qartësohet përvoja menaxheriale e nevojshme që kërkohet për aplikimin e kandidatëve për komisioner.
- Agjencia për Informim dhe Privatësi të publikoj rekomandimet, udhëzimet, opinionet, sqarimet dhe qëndrimet për çështjet në fushën e mbrojtjes së të dhënave, si dhe të dhënat tjera që kërkohen me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.